



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 325/5 prot.

Tiranë, 28.8.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik Florian Ballhysa kundër vendimit nr. 47, datë 25.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Astrit Faqolli
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 13.8.2018, është njoftuar vendimi nr. 47 datë 25.7.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Astrit Faqolli, magjistrat/gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, kandidat për anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga dita e njoftimit.

Brenda këtij afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 47, datë 25.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit z. Astrit Faqolli është magjistrat/gjyqtar prej vitit 1997 dhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi në kohë, pasi është një nga kandidatët për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Nga viti 1997 deri në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë Librazhd, nga viti 2003 deri në vitin 2010 ka ushtruar detyrën e inspektorit pranë Inspektoratit të KLD-së, nga viti 2010-2013 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe nga viti 2013 e në vazhdim ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

3. Mbështetur në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Astrit Faqolli ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuar për këtë subjekt nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim i referuar si Inspektorati), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Astrit Faqolli¹*”, ka referuar për subjektin, se:

- i. Ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin², ka referuar “*Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

3.3 Inspektorati, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit³ raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku (6 të tillë), Komisioni nuk ka gjetur elemente që mund të ngrenë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

4. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 Për vlerësimin e pasurisë. Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarameve periodike të subjektit, krahasuar me atë të deklaratës “Vetting”, kontrollin e pasurive të deklaruara, burimin e krijimit të tyre, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Nga kontrolli financiar-ligjor për 2 pasuri të paluajtshme, një autoveturë, të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni arsyeton: “*...Subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë: - pakësimin e gjendjes*

¹ Protokolluar pranë Komisionit me nr.*** prot., datë ***.11.2017.

² Protokolluar pranë Komisionit me nr.*** prot., datë ***.11.2017.

³ Protokolluar pranë Komisionit me nr.*** prot., datë ***.11.2017.

cash në deklarimin e tij në vitin 2006; - deklarimin në “lekë të vjetër” në vitet 2004 dhe 2005 të kursimeve cash... Por, nuk u gjetën prova apo indice që këto pasaktësi në deklarime janë bërë me qëllim fshehjen e burimit, të ardhurave apo pasurisë. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, këto pasaktësi nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia. Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit Astrit Faqolli nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit”⁴.

4.1.1 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti z. Astrit Faqolli ka arritur një nivel të besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

4.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportin e DSIK-së, ku është arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e papërshtatshmërisë për “...vazhdimin e detyrës, pasi konsiderohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga struktura kriminale, sipas përcaktimit të germës “c”, të nenit 37, të ligjit 84/2016”.

4.2.1 Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni ka kryer hetim të thelluar për verifikimin e rrethanave dhe provave dhe rrethanave lehtësuese që ka marrë parasysh grupi i punës së DSIK-së, në rezultatin e nxjerrë. Pas përfundimit të këtij hetimi të thelluar administrativ, në vendimin e Komisionit argumentohet se: “...informacioni i përcjellë nuk bazohet mbi prova të sakta, konsiderohet i paplotë dhe nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016. Grupi i punës nuk ka bërë verifikim të mëtejshëm për të sqaruar në mënyrë shteruese të gjitha rrethanat e çështjes dhe vetëm mbi bazën e informacionit të paverifikuar ka dalë në përfundim të gabuar mbi papërshtatshmërinë e subjektit. Referuar nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konstatuar se nuk është gjetur asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.”

4.2.2 Në bazë të këtyre përfundimeve të arritura në përfundim të hetimit administrativ përkatës, Komisioni ka çmuar se subjekti është në kushtet e duhura ligjore për t’u konsideruar si i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

4.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44, të ligjit nr. 84/2016, dhe kreut II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga Inspektorati⁵, vlerësimin “i aftë” nga ana e relatorit të çështjes, ka arritur në konkluzionin se

⁴ Shih faqen 32 të vendimit.

⁵ Bazuar në formularin e vetëdeklarimit, 5 dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, tetor 2013 - tetor

nuk është gjetur asnjë indicie apo element që mund të ngrejë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e magjistratit/gjyqtar. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, duke e kategorizuar si “i aftë”.

4.4 Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

II. Shkaqet e ankimit

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga dispozitat e nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, neneve 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.

8. Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin në detyrë ose shkarkimin e magjistratit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara në fashikullin përkatës për çdo subjekt.

9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik gjatë shqyrtimit të vendimit nr. 47, datë 25.7.2018, të Komisionit, e ka kryer këtë kontroll bazuar në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore.

9.1 Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj, Komisioneri Publik konstaton se, për sa i takon i) kriterit të kontrollit të figurës dhe ii) kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vendimi nr. 47, datë 25.7.2018, i Komisionit, bazohet në provat dhe faktet që janë administruar gjatë hetimit administrativ.

9.2 Ndërkohë, në lidhje me iii) kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, vendimi i Komisionit nuk gjen mbështetje në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ.

2016, për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur gjithsej 7 ankesa në KLD. Pesë nga këto ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar dhe për dy të tjerat, nga verifikimi, ka rezultuar se janë të pabazuara.

9.3 Gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të kriterit të pasurisë për subjektet që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin dhe hetimin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, kontrollin e pasurisë, ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj dhe i përmbushjes së detyrimeve të ligjshme financiare, përfshirë interesat privatë të subjektit dhe personave të lidhur me të.

9.4 Duhet nënvizuar se, në çdo rast, për arritjen e nivelit të besueshmërisë në vlerësimin e këtij kriteri, subjekti duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave.

9.5 Mbështetur në kërkesat kushtetuese e ligjore të sipërcituara dhe vlerësimin e provave dhe fakteve të administruara nga hetimi administrativ, në rastin konkret ky ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 47, datë 25.7.2018, të Komisionit ushtrohet për i) kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, z. Astrit Faqolli.

10. Komisioneri Publik çmon se, mbështetur në provat e administruara gjatë hetimit administrativ, bazuar në përmbajtjen e dispozitave përkatëse kushtetuese dhe atyre të ligjit nr. 84/2016, vendimi nr. 47, datë 25.7.2018, duhet të ndryshohet, duke u vendosur shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit z. Astrit Faqolli, për shkak të deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë.

A. Vlerësimi i pasurisë

11. Në deklaratën “Vetting”, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, nga subjekti i rivlerësimit z. Astrit Faqolli, në datë 30.1.2017, rezulton se ai dhe subjekti i lidhur (bashkëshortja ***.***) kanë deklaruar në bashkëpronësi të tyre (për efekt të regjimit martesor) këto pasuri:

A.1. Apartament banimi me sipërfaqe 83.31 m², me adresë rr. “****”, ***, paguar vlera prej 42.300 euro në vitin 2006 dhe formalizuar akti noterial i kalimit të titullit të pronësisë në ***.8.2015. Si burim i krijimit të pasurisë, në deklaratën “Vetting” është deklaruar: të ardhura familjare ndër vite.

A.2. Truall + ndërtesë tri kate më sipërfaqe 32 m² (32 m²+32 m²+48 m²), në qytetin e ***, me vlerë 2.786.720 lekë, regjistruar në regjistrat hipotekor të ZVRPP-së ***, në vitin 2011. Si burim i krijimit të pasurisë, në deklaratën “Vetting” është deklaruar: të ardhurat familjare ndër vite.

A.3. Automjet tip Mercedes Benz, blerë në datë ***.3.2014, me vlerë 5.000 euro. Si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: të ardhurat familjare ndër vite.

12. Komisioneri Publik, pasi vlerësoi provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, bazuar në interpretimin ligjor të dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, konstaton se Komisioni ka arritur në përfundime të gabuara për sa i takon vlerësimin të pasurive të subjektit të rivlerësimit z. Astrit Faqolli.

A.1. Pasuria: Apartament banimi me sipërfaqe 83.31 m², me adresë rr. “****”, ***, paguar vlera prej 42.300 euro në vitin 2006 dhe formalizuar akti noterial i kalimit të titullit të pronësisë në ***.8.2015. Si burim i krijimit të pasurisë, në deklaratën “Vetting” është deklaruar: të ardhura familjare ndër vite.

13. Rezulton se në kontratën e sipërmarrjes për këtë pasuri të paluajtshme, të nënshkruar në datë ***.1.2006, subjekti i deklarimit dhe Shoqëria “****” sh.p.k. kanë rënë dakord që çmimi i

sendit të paguhet në tri këste, i) kësti i parë, prej 15.000 euro, në momentin e nënshkrimit të kontratës, ii) kësti i dytë, prej 20.000 euro deri në datë ***.8.2006 dhe iii) kësti i tretë, prej 7.300 euro, deri në dhjetor 2006.

13.1 Gjatë hetimit administrativ, kjo pasuri e paluajtshme rezulton të jetë deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2006, dorëzuar në ***.3.2007, për një vlerë prej 43.300 euro.

13.2 Në këtë deklaratë, në lidhje me burimin e të ardhurave për pagesën e vlerës së mësipërme, subjekti ka deklaruar tre zëra të ardhurash:

i) pakësim në vlerën 2.300.00 lekë nga gjendja e kursimeve CASH të mbajtura në shtëpi, e akumuluar ndër vitet 2003, 2004, 2005,

ii) hua nga kunati z. ***.***, në vlerën 10.000 euro dhe

iii) shitje automjet tip Mercedes Benz, në vlerën 250.000 lekë.

13.3 Ndërkohë, në deklaratën “Vetting”, të dorëzuar në datë 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim krijimi: të ardhurat familjare ndër vite.

i) Kursime

14. Në verifikim të këtyre deklarimeve në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme, rezultoi se, në datë 5.3.2004, nëpërmjet dorëzimit të deklaratës përkatëse, subjekti i rivlerësimit z. Astrit Faqolli ka deklaruar për herë të parë interesat e tij privatë, bazuar në ligjin nr. 9049/2003.

14.1 Në këtë akt, të administruar si provë nga ana e Komisionit, në kuptim të nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron si kursime një shumë prej 5.000.000 lekë, të mbajtura CASH në shtëpi.

14.2 Në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë, dorëzuar në datë 24.3.2005, subjekti i rivlerësimit z. Astrit Faqolli deklaroi një shtim të kursimeve CASH të mbajtura në shtëpi, në masën 1.000.000 lekë.

14.3 Në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë, dorëzuar në datë 30.3.2006, subjekti i rivlerësimit z. Astrit Faqolli deklaroi një shtim të kursimeve CASH të mbajtura në shtëpi, në masën 800.000 lekë.

14.4 Nga deklaratimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit, në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, datë ***.1.2006, z. Astrit Faqolli rezultoi të ketë pasur kursime në shtëpi CASH, një shumë në vlerën prej 6.800.000 lekë, shumë kjo që mundësonte pagesën e plotë të vlerës së çmimit të sendit, pa pasur nevojë të lidhte një marrëdhënie huamarrje me kunatin, z.***.***, për vlerën 10.000 euro.

15. Gjatë hetimit administrativ, nga analiza financiare e kryer, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të argumentuar mundësitë e kursimit të vlerës 5.000.000 lekë deri në vitin 2003 dhe, përkatësisht, kursimet në vlerën 1.000.000 lekë, për vitin 2004 dhe 800.000 lekë, për vitin 2005.

15.1 Pasi ka administruar përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto çështje për të cilat i ishte kaluar barra e provës, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *“Nga përlllogaritja e kursimeve sipas deklarimeve në këto tri vite, rezultoi se subjekti nuk i kishte mundësitë*

financiare për të paguar as këstin e parë për këtë apartament. Në këto kushte u kërkua deklarimi i tij për të konfirmuar saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave në deklaratat e mëparshme. Subjekti, në përgjigje të pyetjeve të Komisionit, ka deklaruar se shuma deklaruar në vitin 2003 i referohet vlerës në “të reja”, ndërsa dy shumat e tjera, përkatësisht 2004 dhe 2005, janë shprehur në “të vjetra”. Për vitet 2004 dhe 2005, subjekti ka deklaruar dhe konfirmuar këtë deklaram se shumat që ka kursyer kanë qenë përkatësisht 100.000 lekë dhe 80.000 lekë... Nga analiza e këtyre fakteve, Komisioni konstaton se subjekti ka gabuar në deklarimin e kursimeve të tij për vitin 2004 dhe 2005, duke përdorur për këtë deklaram nociónin “lekë të vjetër”. Por, subjektit nuk mund t’i mohohet vërtetësia e deklarimit të kursimeve në vitin 2003 për shumën 5.000.000 lekë, duke pasur parasysh të ardhurat e siguruara nga aktiviteti i farmacisë në pronësi të bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga paga e vetë subjektit. Komisioni vlerëson se subjekti ka gabuar, duke mos i dhënë rëndësi dhe kushtuar kujdes një dokumenti zyrtar. Në të njëjtën kohë, Komisioni arsyeton se ky gabim nuk mund të konsiderohet i qëllimshëm, përderisa nuk arrihet të vërtetohet se mund të kemi të bëjmë me fshehje të burimit të ligjshëm apo fshehje të pasurisë. Nga ana tjetër, Komisioni çmon se kemi të bëjmë me një pasaktësi në deklaratat e viteve 2004 dhe 2005, pra jo në Deklaratën Vetting, që është dokumenti mbi të cilin bazohet rivlerësimi. Më tej, Komisioni arsyeton se kjo pasaktësi nuk lidhet me deklarimin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016. Nxjerrja e konkluzionit për “deklaram të pamjaftueshëm”, në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti, sipas Deklaratës Vetting, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë apo kur tenton të kryejë fshehje, apo deklaram të rremë të pasurisë”.

15.2 Ky përfundim i Komisionit rezulton të mbështetet në një analizë financiare që i është bërë të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, në cilësinë e personit të lidhur, gjatë procesit të rivlerësimit, kryesisht duke u bazuar në pretendimet e paraqitura nga vetë subjekti.

15.3 Këto pretendime janë parashtruar në vëmendjen e Komisionit, vetëm pasi subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës për të vërtetuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kursimeve, që kanë shërbyer për pagesën e çmimit të sendit të paluajtshëm.

15.4 Kështu, Komisioni rezulton se ka bërë llogaritjen e të ardhurave të krijuara nga ana e personit të lidhur, bashkëshortja ***,***, vetëm duke u nisur nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, duke llogaritur një normë më të lartë fitimi, përtej atyre të parashikuara nga legjislacioni, pa pasur asnjë dokument provues apo indicie për sa pretendohet nga z. Astrit Faqolli, në lidhje me burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie (kursime CASH).

16. Ndryshe nga përfundimet e arritura nga Komisioni, të cilat janë pasqyruar në pjesën arsyetuese të vendimit nr. 47, datë 25.7.2018, në vlerësimin e Komisionerit Publik, në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave që janë deklaruar se kanë shërbyer për blerjen e pasurisë së paluajtshme: “I. Apartament banimi me sipërfaqe 83.31 m², me adresë rr. “***”, “***”, subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, në referencë të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

16.1 Duke iu referuar akteve dhe provave të administruara në fashikullin përkatës, në lidhje me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit deklaroi se pjesën më të madhe të kursimeve e ka realizuar kryesisht me të ardhurat nga puna e bashkëshortes si person fizik, farmacistë në qytetin e ***, nga viti 1999 - 2003.

16.2 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur me cilësinë e provës shkresën nr.*** prot., datë ***.10.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore ***. Në këtë akt shkresor, të kërkuar nga subjekti i lidhur, gjatë plotësimit nga subjekti të deklaratës “Vetting”, rezulton se bashkëshortja ***,***, për periudhën 1999-2002, është subjekt tatimpagues. Nga përmbajtja e shkresës rezulton të mos referohet qarkullimi real i aktivitetit të subjektit, por pasqyrohet e dhëna se xhiro fikse vjetore e tatueshme në rastin konkret deklarohet me fashë deri në 2.000.000 lekë/vit, për të cilat subjekti tatimpagues (personi i lidhur) ka paguar vlerën përkatëse të detyrimit tatimor.

16.3 Konstatohet po ashtu se vetë Komisioni, gjatë kryerjes së verifikimeve në hetimin administrativ, për këtë çështje i është drejtuar me shkresë administratës tatimore.

16.4 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni nuk ka mundur të verifikojë dot fitimin real të aktivitetit të bashkëshortes së subjektit. Kjo për shkak se Drejtoria Rajonale Tatimore ***, me shkresën nr.*** prot., datë ***.2.2018, kthim përgjigje kërkesës së Komisionit, ka konfirmuar se për tatimpaguesin ***,*** nuk disponohen të dhëna për qarkullimin, fitimin dhe humbjen në vite dhe nuk ka të dhëna mbi pasqyrat financiare dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të deklaruara.

16.5 Në mungesë të dokumentacionit që vërteton fitimin real të subjektit tatimpagues, referuar në VKM-në nr.182, datë 25.4.1995, “Për çmimet e shitjes së barnave”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka analizuar me marzh maksimal fitimi prej 35%, për aktivitetin privat/shitje barna, ka konkluduar se subjekti rezulton me të ardhura të pamjaftueshme për krijimin e kursimeve në shumën 5 milionë lekë⁶.

16.6 Lidhur me këtë pamjaftueshmëri, subjekti në shpjegimet e tij, protokolluar pranë Komisionit, në datë 18.6.2018, pohon që marzhi i fitimit mund të shkonte deri në 40%⁷, duke qenë se farmacia realizonte edhe shitje artikujsh kozmetikë, që kishin një marzh më të lartë fitimi. Këtë pretendim të tij, subjekti nuk e ka shoqëruar me asnjë dokumentacion provues⁸, edhe pse Komisioni ia ka kërkuar shprehimisht⁹.

16.7 Komisioni, në analizën e re financiare të të ardhurave familjare të subjektit, deri në vitin 2003, është mjaftuar vetëm me këtë pretendim të subjektit dhe ka rillogaritur të gjithë xhiron e deklaruar me një tjetër normë fitimi prej 40%¹⁰, duke arritur në rezultat të ndryshëm, dhe tanimë vlerëson se subjekti ka pasur mundësi kursimi të shumës prej 5.000.000 lekë.

16.8 Është shumë e rëndësishme të parashtrohet se në analizën financiare për të llogaritur kursimin në vlerën prej 5.000.000 lekë, Komisioni nuk ka llogaritur si shpenzime një vlerë prej 500.000 lekë, që vetë subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në vitin 2004, si shpenzime për blerjen e i) një trualli (vlera 150.000 lekë - blerë në ***.7.2003) dhe ii) një automjeti (vlera 350.000 - blerë në ***.1.2003).

16.9 Nisur nga përfundimi që arrin Komisioni për ligjshmërinë e të ardhurave në krijimin e shumës së kursimeve në vlerën prej 5.000.000 lekë deri në vitin 2003, Komisioneri Publik vlerëson se analiza financiare e bërë nga Komisioni është e gabuar dhe nuk mbështetet në

⁶ Shiko faqen 20 të vendimit.

⁷ Deklaron se krahas barnave mjekësore tregton dhe produkte kozmetike.

⁸ Në bazë të nenit 32, pika 1, të ligjit 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të duhet të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

⁹ Shiko komunikimin përmes postës elektronike, datë ***.6.2018, pika III) në lidhje me të ardhurat.

¹⁰ Shiko faqen 21 të vendimit.

dokumente provuese që vërtetojnë deklaratimet e subjektit për sa i përket marzhit të fitimit, përcaktues në burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga aktiviteti privat, farmaci e bashkëshortes, detyrim ky i parashikuar në nenin 32, të ligjit 84/2016¹¹.

17. Nga analiza financiare dhe verifikimet e kryera nga ana e Komisionerit Publik mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion për periudhën deri në vitin 2003, na rezulton se kursimi i deklaruar në masën 5.000.000 lekë nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme, pasi subjekti dhe bashkëshortja e tij *nuk kanë pasur* mundësi kursimi në këtë shumë (shih tabelën nr. 1).

17.1 Totali i të ardhurave të ligjshme familjare të subjektit për periudhën deri në 2003 është rreth 6.014.356 lekë, ndërsa kursimi i deklaruar prej 5.000.000 lekësh është relativisht i lartë dhe përbën rreth 83% të të ardhurave totale familjare, për periudhën 1997 - 2003.

Tabela nr.1

Realizimi i të ardhurave	Total të ardhura
Të ardhura bashkëshortja 1999 - 2003	3.120.400 ¹²
Të ardhura subjekti 1997 - 2003	2.893.956
Total të ardhura familjare	6.014.356
Kursimi i deklaruar deri në 2003	5.000.000
	83.13 %
Raporti kursim/të ardhura	

17.2 Në analizën financiare të mësipërme të Komisionerit Publik, fitimi për aktivitetin privat farmaci është llogaritur me marzh maksimal 35%, sipas parashikimeve të VKM-së nr.182, datë 25.4.1995, “Për çmimet e shitjes së barnave”, të ndryshuar.

17.3 Edhe nga kjo llogaritje, e realizuar me marzhin e fitimit maksimal dhe duke e konsideruar xhiron në nivelin maksimal të fashës, sipas shkresës nr.*** prot., datë ***.10.2016, së DRT *** , përsëri rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, në kuptim nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19, të ligjit 84/2016, për të realizuar kursimin e deklaruar, që është përdorur i gjithi për blerjen e kësaj pasurie, referuar deklaratimeve të subjektit në pyetësorët e dërguar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit.

17.4 *Lidhur me kursimet e deklaruara në vijim në vitet 2004 - 2005*: subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 deklaroi kursime në shumën 1.000.000 lekë dhe 800.000 lekë kursime të tjera në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005. Nga analiza financiare e të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve të viteve 2004 dhe 2005, ashtu si edhe të Komisionit në qëndrimin e parë të tij, na rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruara.

17.5 Fillimisht, edhe Komisioni ka arritur në përfundimin që subjekti nuk kishte mundësitë financiare për të krijuar kursimet e deklaruara në vitet 2004 - 2005, madje as për të paguar

¹¹ “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaratimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.”

¹² Marzhi i fitimit është llogaritur në masën 35% e xhiros sipas VKM-së nr.182, datë 20.4.1995, “Për çmimet e shitjes së barnave”, si i vetmi burim zyrtar për të përcaktuar marzh fitimi, pasi subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë dokument që të vërtetojë fitimin real të ligjshëm.

këstin e parë të apartamentit¹³, duke i kaluar subjektit barrën e provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016.

17.6 Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorëve gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në shpjegimet përfundimtare para Komisionit, datë ***.7.2018, pohon se deklarimi i vlerave të kursimeve më sipër është i pasaktë dhe thekson që kursimet në vitin 2003 i ka deklaruar në “lekë të rinj”, ndërsa në vitin 2004 dhe 2005 deklarimet janë në “lekë të vjetër”.

17.7 Lidhur me kuptimin dhe përdorimin e konceptit të monedhës zyrtare nga subjekti, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka gabuar në deklarimin e kursimeve të tij për vitin 2004 dhe 2005, duke përdorur për këtë deklarim nocionin “lekë të vjetër”, duke mos i dhënë rëndësi dhe kushtuar kujdes një dokumenti zyrtar, duke konsideruar si të paqëllimshme deklarimet e pasakta lidhur me kursimet në deklaratat e viteve 2004 -2005, me argumentin se janë bërë në deklarimet periodike dhe jo në atë “Vetting”. Komisioni arsyeton në vijim se kjo pasaktësi nuk lidhet me deklarimin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016. Sipas Komisionit, nxjerrja e konkluzionit për “deklarim të pamjaftueshëm”, në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti, sipas Deklaratës Vetting, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë apo kur tenton të kryejë fshehje, apo deklarim të rremë të pasurisë.¹⁴

17.8 Ky argument i Komisionit bie ndesh me nenin 32, pika 5, të ligjit 84/2016, sipas të cilit deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

18. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, një interpretim i tillë, që po përsëritet në rrethana të ngjashme nga ana e Komisionit, në disa vendimeve radhazi, ka nevojë për të gjetur trajtim shterues, me qëllim shmangien e praktikave të ndryshme.

18.1 Kështu, kuptimi që i jep Komisioni në vendimin e tij, pikës 2 të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, është i formuluar në një mënyrë të tillë që ka më shumë të vërteta (saktësi), sesa pasaktësi, por për nga rëndësia, pasaktësia në raportin që i jep deklaratës “Vetting” me deklaratat ndër vite të çon në një konkluzion të gabuar.

18.2 Më konkretisht, Komisioni jep kuptimin e tij mbi pikën 2, të nenit D, të Kushtetutës si vijon:

“Komisioni arsyeton se pika 2 e nenit D, të aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzojë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht kjo deklaratë dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të Pasurisë, dhe jo me deklarimet e mëparshme të tij. Këto deklarime, mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të Deklaratës Vetting dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklarimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë”.

¹³ Shih faqen 19 të vendimit.

¹⁴ Shih faqen 21 të vendimit.

18.3 Komisioneri Publik çmon se dispozita kushtetuese në rastin konkret nuk ka zgjedhur të ketë parashikime të detajuara, që i ngjajnë një norme ligjore që i përket një ligji të zakonshëm, duke përcaktuar terma konkretë të zbatimit praktik, siç mund të ishte në ligjin e posaçëm për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorë apo ligjin e posaçëm për kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë.

18.4 Pra, në vlerësimin e Komisionerit Publik, Kushtetuta nuk përcakton se deklarata “Vetting” është dokumenti ligjor nga ku fillon përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit apo që Kushtetuta ta ketë lidhur këtë përgjegjësi drejtpërdrejt me deklaratën “Vetting” dhe jo me deklaratimet e bëra ndër vite.

18.5 Ky kuptim i thjeshtëzuar devijon qëllimin e dispozitës kushtetuese, që është të identifikojë atë subjekt rivlerësimi, i cili ndodhet në situatën ligjore që justifikon marrjen e masës disiplinore dhe më konkretisht në rastet kur:

- a) *ka pasuri më të madhe sesa dyfishi i pasurisë¹⁵ së ligjshme;*
- b) *nuk e ka deklaruar saktësisht pasurinë e tij dhe të personave të lidhur;*
- c) *nuk i ka deklaruar plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur;*
- d) *nuk shpjegon bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij.*

18.6 Sikurse është formuluar dispozita kushtetuese, i rëndësishëm është qëllimi (shkaku) dhe pasoja (masa disiplinore që merret) është rrjedhojë e tij. Duke qenë se qëllimi është identifikimi i atyre subjekteve që kanë pasuri nga burime jo të ligjshme, kanë bërë deklaratime të rreme, kanë fshehur pasuritë, nuk shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, çdo rrethanë, fakt apo provë është e rëndësishme dhe merr vlerë (çmohet) gjatë hetimit administrativ dhe jo paraprakisht.

18.7 Në këtë kuptim, Komisioneri Publik ka një qëndrim të kundërt nga sa shprehet Komisioni në vendimin konkret, për sa i përket kuptimit dhe vlerës që i jepet deklaratës “Vetting” si shkak i vetëm kushtetues për masën disiplinore të shkarkimit dhe raportit të saj me deklaratat vjetore të bëra ndër vite.

18.8 Duke qenë se trupat gjykuese të Komisionit, lidhur me kuptimin e nenit D të Kushtetutës duhet të kenë të njëjtin kuptim dhe zbatim të kuadrit kushtetues dhe ligjor për procesin e rivlerësimit, e gjejmë me vend të nënvizojmë që tashmë Kolegji ka një jurisprudencë të krijuar në këtë drejtim. Nisur nga dispozitivi i shpallur i dy vendimeve të Kolegjit, me anë të të cilave është vendosur lënia në fuqi e vendimeve nr. 12 dhe 14 të Komisionit, vlerësojmë se interpretimi që Komisioni i bën nenit D të aneksit të Kushtetutës, në rastin konkret, është i gabuar.

19. Duke iu rikthyer rastit konkret të subjektit të rivlerësimit z. Astrit Faqolli, marrë në konsideratë formimin profesional të magjistratit/gjyqtar, prezumohet se subjekti ka aftësitë e mjaftueshme për të kuptuar rëndësinë e dokumenteve zyrtare dhe përgjegjësinë që pasjellë një deklaram i tillë (mospërdorimi i saktë i konceptit të monedhës zyrtare), pasi shqyrtimi i dokumenteve dhe vlerës provuese të tyre është pjesë e ushtrimit të detyrës së tij.

¹⁵ Pasuritë janë sende të luajtshme dhe të paluajtshme, në pronësi, posedim, përdorim. Praktika e deritanishme na orienton drejt sendeve të luajtshme, të tilla si: automjete, likuiditete (të ardhura) që gjenden në formën -cash, -depozitë, -llogari rrjedhëse, -aksione, -bono thesari, -hua dhe sendeve të paluajtshme, të tilla si: -ndërtesa, -toka.

19.1 Argumenti që përdor Komisioni është i mangët dhe joligjor, edhe për faktin e thjeshtë se subjekti në deklarinin fillestar periodik vjetor të vitit 2003, nuk ka pasur “gabime të tilla”, duke deklaruar saktë vetëm monedhën zyrtare “lekë të rinj”.

19.2 Shpjegimi i subjektit nuk qëndron as logjikisht, pasi brenda së njëjtës deklaratë¹⁶ subjekti *gabon vetëm* në deklarinin e kursimeve në “lekë të vjetër” ndërsa të ardhurat *i deklaroi drejt*, në “lekë të rinj”. Nga sa më sipër, bindshëm, vërtetohet që deklarimi i subjektit për kursimet 2004 - 2005 është i pamjaftueshëm në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

19.3 Subjekti në deklaratën periodike të vitit 2006 deklaroi si burim për blerjen e apartamentit kursime nga të ardhurat e pagave ndër vite dhe huan marrë nga kunati nga ***.*** në shumën 10.000 euro. Në po të njëjtën deklaratë, ai deklaroi *pakësimin e kursimeve në masën 2.300.000 lekë*.

19.4 Duke marrë në konsideratë deklarinimet e subjektit për likuiditetin e përdorur për blerjen e kësaj pasurie, shuma totale 2.300.000 lekë + 1.237.000¹⁷ lekë = 3.537.000 lekë, nuk justifikon blerjen e apartamentit në vlerën 5.232.000 lekë.

19.5 Në përgjigjet e tij, protokolluar pranë Komisionit, në datë ***.6.2018, subjekti sqaron *se shuma e kursyer deri në vitin 2006 ka qenë 5.180.000 lekë dhe e gjitha kjo shumë është përdorur për blerjen e apartamentit. Huaja nga kunati, pjesërisht në vlerë 850.000 lekë, është përdorur për arredimin e tij, ndërsa diferenca e mbetur është mbajtur CASH në shtëpi*.

19.6 Në të njëjtin pyetësor, subjekti bëri deklarinime kontradiktore lidhur me kursimet, duke deklaruar: *“...në deklaratën 2006 kam deklaruar për blerje shtëpi banimi pakësimin e kursimit në shumën 2.300.000 lekë. Mënyra e të shprehurit në deklaratë nuk ka qenë e duhura dhe jo e saktë, pasi si dhe sqarova më sipër, vlera e apartamentit është likuiduar e gjitha brenda vitit 2006, dhe për këtë është përdorur e gjithë gjendja cash, në shumën 5.180.000 lekë”*.

19.7 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit për pakësim CASH shumën 2.300.000 lekë, nuk përputhet me asnjë nga deklarinimet e mëpasshme të bëra pas vitit 2006 dhe as me llogaritjet mbi bazën e dokumentacionit të administruar. Në shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit, protokolluar pranë Komisionit me nr.*** prot., datë ***.7.2018, ai konfirmon qëndrimin e Komisionit dhe nuk ka paraqitur asnjë provë¹⁸ për të konsideruar si të vërtetë deklarinimin e bërë prej tij në 2006.

19.8 Nga provat e administruara në dosje¹⁹ dhe shpjegimet e palëve në vlerësimin e Komisionit Publik, ky deklarim i pakësimit të CASH-it nga subjekti nuk është i vërtetë dhe lidhet drejtpërdrejt me detyrimin e tij për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, dhe nga këndvështrimi ynë vlerësojmë që subjekti është përpjekur të fshehtë dhe paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi²⁰.

19.9 Duke marrë në konsideratë sa analizuar më sipër mbi të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit, kursimet e mundshme deri në fund të vitit 2003 dhe deklarinimet e subjektit gjatë

¹⁶ Shiko rubrikën kursime dhe të ardhura në deklaratën periodike 2004, ashtu edhe në atë 2005.

¹⁷ Kundërvlera në lekë e huas së deklaruar 10.000 euro me kursin mesatar të vitit 2006.

¹⁸ Në përputhje me nenin 52, të ligjit 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të kundërtën.

¹⁹ Sipas mandateve të pagesave bashkëlidhur shkresës së Shoqërisë *** sh.p.k., datë ***.7.2018, rezultoi se gjendja CASH për vitin 2006 është pakësuar në vlerën e çmimit të blerjes së pasurisë 2, në shumën 5.180.000 lekë.

²⁰ Detyrim i parashikuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës.

procesit të rivlerësimit (se shumat e kursyera në 2004 - 2005 gabimisht janë deklaruar në lekë të rinj, ndërkohë kursimet e këtyre dy viteve kanë qenë 100.000 lekë dhe 80.000 lekë), konstatohet se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 1 dhe 3 të nenit D, të aneksit të Kushtetutës për një shumë prej 1.167.787 lekë, kursimet e deklaruara të përdorura për blerjen e kësaj pasurie (referohu tabelës nr. 2).

Tabela nr. 2

Analizë financiare për kursimet e deklaruara	Lekë
Totali të ardhura familjare deri në 2003	6.014.356 ²¹
Shpenzime deri në vitin 2003	2.182.143 ²²
Diferencë e mundshme për kursim deri në 2003	3.832.213
Kursimet e deklaruara 2004 - 2005 (gjatë procesit të rivlerësimit)	180.000
Kursime të mundshme deri në vitin 2006	4.012.213
Kursime të deklaruara (gjatë procesit të rivlerësimit)	5.180.000
Diferencë e pambuluar e kursimeve	(1.167.787)

19.10. Për kursimet e deklaruara në vitin 2003 - 2005 nga analiza financiare (tabela nr. 2) na rezultojnë se subjekti *nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruara në vitin 2003, si dhe pagesën për blerjen e kësaj pasurie*, për të cilën deklaroi se: shuma e kursyer prej 5.180.000 lekë është përdorur e gjitha për pagesat për blerjen e apartamentit, *për një diferencë prej 1.167.787 lekësh* dhe, si rrjedhim, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë dhe burimet e krijimit në deklaratat vjetore 2003 - 2006 dhe në deklaratën “Vetting”.

ii) Hua nga personi tjetër i lidhur z. *.*****

20. Shtetasi ***.***, i vitlindjes ***, është kunati i subjektit të rivlerësimit z. Astrit Faqolli, vëllai i personit të lidhur, ***.***, bashkëshortja e z. Astrit Faqolli.

20.1 Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi se ka marrë hua nga z. ***.*** për blerjen e apartamentit në rr. “***”, ndërkohë që në deklaratën e interesave private periodikë/vjetorë, të dorëzuar në vitin 2007, një nga zërat e të ardhurave të deklaruara për blerjen e sendit është huaja e marrë prej këtij personi tjetër të lidhur në vlerën prej 10.000 euro.

20.1.1 Në vendimin e tij, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *“Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e pasurisë apartament në rrugën “***” i ka marrë hua, në shumën 10.000 euro, vëllait të bashkëshortes, shtetasit ***.***. Subjekti ka deklaruar se kjo marrëdhënie nuk ka qenë e shkruar. Pasi është pyetur nga ana e Komisionit, ai ka deklaruar se këtë hua e ka marrë CASH dhe, për të vërtetuar mundësitë financiare të huadhënësit, ka depozituar kontratën e shitblerjes së banesës nr.*** rep., nr.****

²¹ Të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes llogaritur me marzh maksimal fitim 35% dhe të ardhurat e subjektit sipas vërtetimeve nga organet përgjegjëse.

²² Shpenzime minimale për jetesën, si dhe shpenzimet për blerje autoveture dhe truall, sipas deklarimeve të subjektit.

kol., datë ***.12.2006 (e cituar edhe më sipër), që huadhënësi ka pasur në pronësi të tij... Subjekti ka deklaruar se huan ia ka dhënë ai vetë prindërve të huadhënësit për shkak se ky i fundit jeton në ***. Vlen të theksohet se prindërit e kumatit janë vjehrrri dhe vjehrra e vetë subjektit. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.6.2018, dhënë nga z. ***.***, me cilësinë e babait të huadhënësit, njëkohësisht edhe vjehrrri i subjektit të rivlerësimit. Në këtë deklaratë, babai i huadhënësit ka deklaruar se z. ***.***, ka autorizuar për procedurat e shitjes së apartamentit të tij subjektit e rivlerësimit, i cili ka nënshkruar dhe marrë vlerën e parave të shitjes së tij. Ai ka deklaruar se nga kjo shumë (5.900.000 lekë), subjekti, me cilësinë e dhëndrit të tij, me miratimin dhe lejen e djalit të tij, z. ***.***, ka mbajtur vlerën prej 10.000 eurosh, e cila i nevojitej për të blerë një apartament në emër të tij e vazhës së tij, ndërsa pjesën tjetër nga totali i shitjes, 5.900.000 lekë, ia ka dhënë deklaruesit CASH, ashtu siç ky i fundit kishte rënë dakord me djalin e tij. Gjithashtu, subjektit i është kërkuar të depozitohë edhe deklaratën tatimore vjetore për të ardhurat e huadhënësit në ***, për periudhën kohore 2006 - 2009. Subjekti ka depozituar gjashtë dokumente, që i përkasin shkurtit 2008, dhjetor 2011, dhjetor 2013, tetor 2015 dhe nëntor 2017. Në përfundim të kësaj analize rezulton se huadhënësi ka pasur aftësi huadhënieje. Fakti që kjo hua nuk është e dokumentuar, mund të shpjegohet me afërsinë në lidhje gjinore ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit. Një marrëdhënie e tillë e afërt vërtetohet edhe nga fakti se këtë apartament, për të cilin u argumentua më sipër, subjekti i rivlerësimit e ka përdorur si vendbanim të tij për një kohë të gjatë pa pagesë”.

20.2 Ky përfundim i Komisionit, në lidhje me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, që ka mundësuar huadhënien për subjektit e rivlerësimit në vlerën prej 10.000 euro, nuk është i bazuar në prova dhe në dispozitat e ligjit nr. 84/2016.

20.3 Siç u tha më lart, deklarimi fillestar për huan e marrë është bërë në deklaratën periodike të vitit 2006, por nuk deklarohet në deklaratën “Vetting”.

20.3.1 Në përgjigjet e pyetësorit, protokolluar pranë Komisionit, në datë ***.6.2018, subjekti deklaroi se nga kjo hua, 850.000 lekë janë përdorur për mobilim dhe diferenca, rreth 400.000 lekë, është mbajtur CASH në banesë. Shpenzimi për mobilim dhe gjendja CASH në banesë nuk janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2006 dhe ky fakt nuk rezulton të jetë vlerësuar nga Komisioni.

20.3.2 Ekzistenca e kësaj marrëdhënie huamarrje që prej vitit 2006 mes subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur, në vlerën 10.000 euro, është formalizuar me deklaratë noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.6.2018, vetëm gjatë procesit të rivlerësimit.

20.3.3 Nga kjo deklaratë noteriale provohet se huaja është dhënë CASH nga kunati ***.*** dhe vlera prej 10.000 eurosh është siguruar nga shitja e apartamentit të kumatit, prej 135 m², në rr. “****”, ***.

20.3.4 Lidhur me mundësinë e shtetasit ***.*** për dhënien e huas dhe ligjshmërinë e këtij burimi të ardhurash të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se nga aktet e administruara në dosje, praktika e ZVRPP ***, kunati i subjektit të rivlerësimit, z.***.*** dhe bashkëshortja e tij, z. ***.***, kanë pasur në bashkëpronësi një apartament me sipërfaqe 135 m², në rr. “****” ***.

20.3.5 Këtë pasuri të paluajtshme, personi tjetër i lidhur, z. ***.*** dhe bashkëshortja e tij, znj. ***.*** e kanë blerë nga shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k. me kontratën e shitblerjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2000. Pavarësisht vlerës së pasqyruar në këtë kontratë (2.700.000

lekë), subjekti tjetër i lidhur, gjatë pyetjes së tij nga Komisioni, ka deklaruar se vlera reale e blerjes së apartamentit ka qenë 41.000 USD.

20.4 Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pas ardhjes së tij nga *** në ***, nga viti 2003 deri në vitin 2006, kur ka blerë banesën e tij në rr. “****”, familja e tij ka banuar pa pagesë pikërisht në këtë apartament të blerë në vitin 2000 nga ana e personit tjetër të lidhur, z. ***.*** dhe bashkëshortes së tij.

20.5 Ky apartament, në pronësi të personit tjetër të lidhur, z. ***.*** dhe bashkëshortes së tij, rezulton të jetë shitur për vlerën 5.900.000 lekë, me kontratën e shitjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2006, ku shitësit janë përfaqësuar me prokurë nga vetë subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli.

20.6 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si dokument për të provuar aftësinë huadhënëse të personit tjetër të lidhur, z. ***.***, pikërisht kontratën e shitjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2006.

20.6.1 Duhet nënvizuar se nga krahasimi i kontratës së sipërmarrjes, datë ***.1.2006, për blerjen nga ana e subjektit të rivlerësimit të apartamentit në pronësi të tij me deklarimin e subjektit se një nga burimet e të ardhurave ishte huaja nga personi tjetër i lidhur, z. ***.***, rezulton se subjekti ka shlyer të gjithë vlerën e çmimit, më parë në kohë (datë ***.12.2006) se të realizohej shitja e apartamentit në pronësi të personit tjetër të lidhur (datë ***.12.2006).

20.7 Në deklaratimet e tij si dëshmitar, personi tjetër i lidhur, z. ***.***, ka deklaruar se për periudhën 1997 - 2000: “... jetojmë në *** prej vitit 1997, ku kam studiuar me bashkëshorten dhe pasi vendosëm të qëndrojmë përfundimisht atje dhe blemë shtëpi në ***. Shtëpia e shitur në *** ka qenë si e vetmja gjë që kam bërë më të ardhurat nga karriera si futbollist. Na duhej njëfarë kapitali për të blerë shtëpi atje”.

20.7.1 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës për ekzistencën e aftësisë financiare të personit tjetër të lidhur për të dhënë hua, ka paraqitur dhe gjashtë dokumente (fotokopje të thjeshta) në gjuhën gjermane (me përkthim të thjeshtë në gjuhën shqipe) për periudhën shkurt 2008, dhjetor 2011, dhjetor 2013, tetor 2015 dhe nëntor 2017. Nga ana formale, këto dokumente nuk kanë fuqi provuese, sepse janë kopje pa vulë apostile dhe nuk vërtetohet nënshkrimi i përkthimit nga noteri publik²³.

20.7.2 Ndërkohë që Komisioni kishte kërkuar deklaratimet tatimore të të ardhurave të huadhënësit në ***, për periudhën 2006 - 2009.

20.8 Në çdo rast, aktet e administruara në dosje nuk provojnë mundësinë huadhënëse të personit tjetër të lidhur, z. ***.***, në vitin 2000, vit në të cilin ai dhe bashkëshortja e tij rezultojnë se kanë blerë apartamentin e tyre, që e kanë shitur në vitin 2006.

29. Në përfundim të këtij hetimi, Komisioni ka konkluduar se huadhënësi ***.*** ka pasur aftësi huadhënëse. Ky konkluzion i Komisionit, përveç faktit se nuk provon ligjshmërinë e burimit, vlerësojmë se është i pabazuar, pasi nuk mbështetet në asnjë analizë financiare.

29.1 Po t’i referohemi arsyetimit të Komisionit dhe përmbajtjes së akteve të administruara ka një mospërputhje të dukshme. Nga ana e Komisionit rezulton se nuk është administruar asnjë

²³ Shiko faqen 25 të vendimit të Komisionit.

provë mbi ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur, z. ***.***, që ka shërbyer si burim për dhënien e huas. Kontrata e shitjes e vitit 2006 shërben për të provuar ekzistencën e të ardhurave në momentin e huadhënies, por nuk justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë në vitin 2000.

29.2 Në zbatim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 4, 30 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhet të dilte në përfundimet përkatëse për ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, vetëm pasi të krijonte bindjen se ato (të ardhurat) ekzistojnë në momentin e blerjes së apartamentit në vitin 2000 dhe se ekzistenca e tyre justifikohet nga burime të ligjshme.

29.3 Subjekti i rivlerësimit, duke pranuar këtë marrëdhënie, si dhe huadhënësi në cilësinë e personit tjetër të lidhur, kanë pasur detyrimin ligjor për të provuar dhe justifikuar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj të ardhure, jo në momentin e shitjes në vitin 2006, por në momentin e blerjes në vitin 2000, barrë provueshmërie që në aspektin procedural duhet të ishte provuar me fakte dhe prova gjatë hetimit administrativ të Komisionit, gjë që nuk ka ndodhur.

iii) Shitje automjeti Mercedes Benz 240

30. Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, si zë të tretë të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në rr. “****”, ka deklaruar dhe shitjen e një makinë tip Mercedes Benz 240, për vlerën prej 250.000 lekë. Rezulton se kjo makinë është deklaruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e parë të interesave private periodikë/vjetorë, të dorëzuar në vitin 2004. Sipas këtij deklarimi, pronësia mbi këtë mjet ka kaluar te subjekti i rivlerësimit nëpërmjet një deklarate noteriale në vitin 2003, për një vlerë prej 350.000 lekë.

30.1 Ndërkohë në deklarin e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit pretendon se e ka shitur këtë automjet në vitin 2006, për një vlerë prej 250.000 lekësh, dhe kjo vlerë ka shërbyer si e ardhur për blerjen e apartamentit.

30.2 Ky deklarin i subjektit është marrë i mirëqenë nga ana e Komisionit, në kundërshtim me përmbajtjen e akteve të fashikullit. Nuk rezulton të jetë administruar ndonjë kontratë noteriale, sikundër ligji kërkon, me anë të së cilës të vërtetohet se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, në vitin 2006, të ketë shitur automjetin dhe prej këtij veprimi juridik të ligjshëm të ketë krijuar të ardhura në vlerën prej 250.000 lekësh.

30.3 Në përfundim të arsyetimit ligjor dhe analizës financiare, Komisioneri Publik vlerëson se në rastin e pasurisë: “*I. Apartament banimi me sipërfaqe 83.31 m², me adresë rr. “****”, “****”, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm në zbatim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.*

31. Të tria burimet e deklaruara për krijimin e të ardhurave në vlerën prej 2.400.000 lekësh, që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë së sendit të paluajtshëm, i) kursimet deri në vitin 2006, ii) huaja nga personi tjetër i lidhur, z. ***.***, dhe iii) shitja e automjetit tip Mercedes Benz, nuk rezultojnë të jenë provuar se janë burime të ligjshme në masën e kërkuar, sikundër sanksionon pika 1, 3 dhe 5, e nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

A.2. Truall + ndërtesë tri kate, me sipërfaqe 32 m² (32m² + 32m² + 48m²), në qytetin e ***, me vlerë 2.786.720 lekë, regjistruar në regjistrat hipotekor të ZVRPP ***, në vitin 2011. Si burim i krijimit të pasurisë, në deklaratën “Vetting”, është deklaruar: të ardhurat familjare ndër vite.

32. Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, ka deklaruar në pronësi me pjesë takuese “regjistruar në emër të subjektit”, pasurinë e llojit truall + ndërtim: “Ndërtim 3 kate, bodrum 1 kat + lokal 1kat + banesë 1 kat”, me sipërfaqe ndërtese të paspecifikuar, ZK ***, ndodhur në rrugën “****”, ***.

32.1 Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se deklarimi i kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit është bërë fillimisht në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2011, me vlerë 3.000.000 lekë.

32.2 Në këtë deklaratë, në lidhje me burimin e të ardhurave për pagesën e vlerës së mësipërme, subjekti ka deklaruar dy zëra të ardhurash:

i) kursim ndër vite;

ii) hua nga shtetasi, z. ***, ***, lidhje gjinore, në vlerën 1.000.000 lekë.

32.3 Në deklaratën “Vetting”, në vitin 2017, deklarimi është i njëjtë për të dhënat e ndërtesës, ndërsa vlera është deklaruar 2.786.720 lekë dhe burimi i krijimit deklarohet: “nga të ardhurat familjare ndër vite”. Deklarimi në lidhje me të ardhurat vazhdon të plotësohet në faqen 9 të deklaratës “Vetting”, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, ku përshkruhet huaja 1.000.000 lekë dhe shlyerja e saj.

33. Duke iu referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe disa prej provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare mbi mundësinë e subjektit për mbulimin me të ardhura të ligjshme të ndërtimit të pasurisë në ***, dhe ka konkluduar aftësinë e tij për të mbuluar me të ardhura të ligjshme këtë ndërtim²⁴.

34. Nga shqyrtimi i akteve, Komisioneri Publik konstaton se origjina e krijimit të kësaj pasurie rezulton të jetë fillimisht kontrata e blerjes së truallit me sipërfaqe 32 m², në korrik 2003.

34.1 Sipas kontratës²⁵, blerës është subjekti i rivlerësimit z. Faqolli dhe shitës familja ***. Objekti i kontratës është shitja e një sipërfaqe trualli, ndodhur në qytetin e ***, me sipërfaqe 32 m², për çmimin e blerjes 150.000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës së noterisë.

34.2 Pas kryerjes së procedurave ligjore dhe marrjes së lejes së ndërtimit nga organet kompetente shtetërore për të ngritur një godinë 3 kate në truallin e tij, subjekti i rivlerësimit më datë ***.3.2011, lidh kontratën e sipërmarrjes me Shoqërinë “****” sh.p.k.

34.3 Sipas kontratës²⁶, investitori dhe pronari i truallit ka detyrimin për të bërë pagesat sipas parashikimeve në këtë kontratë. Pasi objekti është ndërtuar, janë kryer procedurat e kolaudimit dhe më pas të lejes së shfrytëzimit.

34.4 Pagesat e bëra nga subjekti i rivlerësimit pasqyrohen në faturat tatimore të datës ***.7.2011 (pagesa për këtë faturë është kryer nga subjekti në datë ***.9.2011) dhe ***.10.2011 (pagesa për këtë faturë është kryer nga subjekti në datë ***.12.2011), në shumën totale 2.786. 861 lekë.

²⁴ Referohu analizës në vendimin e Komisionit faqe13.

²⁵ Kontratë nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2003, lidhur në ***, para noterit ***.***.

²⁶ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.3.2011, lidhur në ***, para noterit ***.***.

34.5 Bashkia *** ka përcjellë pranë ZVRPP *** gjithë dokumentacionin ligjor të ndërtimit, mbi bazën e të cilit lëshohet vërtetimi i pronësisë në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli.

35. Burimet e të ardhurave për të kryer pagesat për këtë pasuri janë deklaruar në mënyrë kontradiktore, duke krahasuar përmbajtjen e deklaratës së interesave privatë/periodikë vjetorë për vitin 2011 dhe deklaratën “Vetting”, si për vlerën, por edhe për burimin, që paraqitet në mënyrë të shpërndarë në dy rubrika të ndryshme të deklaratës “Vetting”.

36. Lidhur me vlerën, këtë mospërputhje subjekti i rivlerësimit e ka shpjeguar se në vlerën 3.000.000 lekë, të deklaruar në vitin 2011, janë llogaritur përveç vlerës së preventivit, edhe taksa e infrastrukturës, e studimit urbanistik, e lejes së shfrytëzimit, si dhe kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë.

37. Komisioni, edhe në këtë rast, vijon me interpretimin se “...Komisioni arsyeton se pika 2 e nenit D, të aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzohë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht kjo deklaratë dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të Pasurisë, dhe jo me deklaratimet e mëparshme të tij. Këto deklarime, mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të Deklaratës Vetting dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklaratimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë”(faqe 9, paragrafi 3, i vendimit të Komisionit).

38. Lidhur me burimin, në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit deklaroi se të ardhurat janë krijuar “nga të ardhurat familjare ndër vite”, në rubrikën “Deklarimi i Pasurisë” dhe në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” përshkruhet fakti i marrjes së huas në vlerën prej 1.000.000 lekë dhe shlyerjen e saj në vitin 2016.

i) Kursimet familjare

39. Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli²⁷, gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit nga Komisioni, ka deklaruar se: “...si burim për ndërtimin e objektit në *** (viti 2011) kanë shërbyer kursimet e mbajtura nga vitet para blerjes së banesës në *** (viti 2006), si dhe kursimet nga vitet 2007, 2008, 2009, 2010”.

39.1. Ky shpjegim i subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, është kontradiktor me vetë deklaratimet e tij²⁸ gjatë procesit të rivlerësimit, sipas të cilave: “...të gjitha kursimet familjare deri në vitin 2006 janë përdorur për blerjen e apartamentit në ***...”.

40. Nga analiza financiare nuk rezulton që edhe për vitin 2006 subjekti i rivlerësimit të ketë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve të deklaruara (referohu analizës për pasurinë apartament banimi në rr. “***”, ***, trajtuar më sipër).

²⁷ Pyetësi nr.***, pa datë.

²⁸ Pyetësi i datës *** qershor 2018.

41. Pavarësisht se në të njëjtin vendim, Komisioni ka pranuar se e gjithë vlera e kursimeve deri në vitin 2006 është përdorur për të blerë pasurinë (apartament) në rr. “****” ***, në arsyetimin që përdor për të verifikuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që shërbyen për ndërtimin e pasurisë (godinë 3-katëshe), në ***, ka marrë të mirëqenë vetëm deklaratimet e subjektit, e mbi bazën e tyre ka kryer dhe analizën financiare përkatëse.

42. Si rezultat i sa më sipër sqaruar, si dhe referuar analizës financiare të periudhës deri në fund të vitit 2010, kursimet familjare të ligjshme të subjektit deri në krijimin e pasurisë (godinë 3-katëshe) në ***, rezultojnë të jenë në shumën 1.000.000 lekë, sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat e interesave vetjakë/periodikë vjetorë për vitet 2007 (500.000 lekë), 2008 (200.000 lekë), 2009 (200.000 lekë) dhe 2010 (100.000 lekë).

ii) Hua nga personi tjetër i lidhur z. *.*****

43. Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, e ka deklaruar këtë marrëdhënie interesi në deklaratën e interesave vetjakë/periodikë vjetorë të vitit 2011.

43.1 Sipas deklaratës noteriale²⁹ të marsit 2012, të bërë nga z. ***.***, subjektit të rivlerësimit z. Astrit Faqolli, prej tij i është “...dhënë hua në shumën 1.000.000 lekë të reja, në muajin gusht 2011, pa afat dhe pa interes, me qëllim ndërtimin e objektit 3-katësh, në qytetin e ***.”

43.2 Fillimisht, në përputhje me parashikimin e nenit 3, pika 14,³⁰ të ligjit nr. 84/2016, për z. ***.***., duke qenë se ka pasur lidhje interesi, që rrjedh nga një interes pasuror (marrëdhënia e huas), nga Komisioni duhej të konsiderohej si person tjetër i lidhur dhe të deklarohet si i tillë.

43.3 Komisioneri Publik vlerëson të nënvizojë se huaja është deklaruar në vlerën 1.000.000 lekë dhe transaksioni është kryer jashtë sistemit bankar.

43.4 Në zbatim të nenit 32, pika 4,³¹ të ligjit 84/2016, duke qenë se me deklaratë noteriale konfirmohet kjo marrëdhënie, personi tjetër i lidhur, z. ***.***., ka detyrimin e justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave.

44. Komisioni ka hetuar lidhur me këtë marrëdhënie huaje në drejtim të *aftësisë huadhënëse* e burimit të ligjshëm të të ardhurave të z. ***, si dhe *konfliktit të interesit* ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z.***.***.

44.1 Për aftësinë huadhënëse dhe burimin e ligjshëm, Komisioni, pas hetimit të kryer, arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka: i) marrëdhënie farefisnie me huadhënësin, ii) nga informatat që ai kishte, ka pasur të ardhura nga emigracioni në shtetin ***, për periudhën 1992-2002, si dhe iii) ka aktivitet privat në fushën e ndërtimit si person fizik i regjistruar nga viti 2005.

44.2 Nga ana dokumentare, Komisioni ka administruar korrespondencën me bankën “****”, nga ku janë konfirmuar në favor të z. ***.***, person fizik në fushën e aktiviteteve në

²⁹ Deklaratë noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.3.2012, lidhur në ***, para noterit ***.***.

³⁰ “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, Komisionerin, Gjyqtarin ose Komisionerin Publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

³¹ Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

ndërtimtari, i regjistruar me NIPT përkatës, tri arkëtime në muajt shkurt - mars 2009, nga Shoqëria “****” sh.p.k., me vlera përkatësisht 1.000.000 lekë, 500.000 dhe 1.000.000 lekë. Të tria këto shuma rezultojnë se janë tërhequr totalisht nga z. ****.****. deri në datë ****.3.2009.

44.3 Bazuar në këto të dhëna, Komisioni ka vlerësuar se z.****.****, si individ, në gusht 2011, dy vjet e gjysmë pas këtyre arkëtimeve si person fizik, ka pasur aftësi huadhënëse në shumën 1.000.000 lekë.

44.4 Ndërkohë, Komisioni ka administruar edhe shkresën e Drejtorisë Rajonale **** me nr.*** prot., datë ****.6.2018, ku jepen të dhëna nga autoriteti shtetëror përgjegjës, mbi personin fizik z. ****. ****., i regjistruar me NIPT ****.

44.5 Por në vendimin e tij, përmbajtjen e kësaj shkrese, Komisioni nuk rezultojnë as t’i referohet dhe as ta bëjë pjesë të analizës financiare, sikundër ligji e detyron.

44.6 Sipas kësaj shkrese, e cila përbën dokument (akt) shtetëror me vlerë të plotë prove, rezultojnë që aftësia (mundësia) huadhënëse e subjektit ****.****, duke konsideruar të tillë fitimin e deklaruar në organet tatimore sipas viteve, respektivisht është si vijon:

- për vitin 2008, në shumën 960.394 lekë;
- për vitin 2009, në shumën 31.836 lekë;
- për vitin 2010, nuk ka deklaruar të dorëzuar në organin tatimor;
- për vitin 2011, nuk ka deklaruar të dorëzuar në organin tatimor.

44.7 Lidhur me aftësinë huadhënëse të personit tjetër të lidhur, z. ****. ****, Komisioni, edhe pse ka administruar shkresën zyrtare të lartpërmendur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve ****³² për personin fizik ****. **** (në cilësinë e subjektit të legjislacionit fiskal), nuk e ka marrë atë në analizë dhe arrin në përfundime të kundërta me sa pasqyrohet në këtë shkresë.

44.8 Sa më sipër, Komisioneri Publik, duke marrë në konsideratë qoftë dhe nivelin minimal të jetës të llogaritur për vitet 2008-2011, vjen në përfundimin se ndryshe nga sa arsyetohet Komisioni, z. ****.****. nuk ka pasur mundësi huadhënëse për subjektin e rivlerësimit në shumën 1.000.000 lekë.

44.9 Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë. Për sa kohë aftësia huadhënëse e personit tjetër të lidhur nuk ekziston, atëherë aq më pak mund të pretendohet ekzistenca e burimit të ligjshëm.

45. Përfundimisht, bazuar në arsyetimin ligjor dhe analizën financiare, për krijimin e kësaj pasurie, që merr në konsideratë nivelin e kursimeve të akumuluar gjatë viteve 2007-2011, të mbuluar me të ardhura të ligjshme, mungesën e provave për mundësinë e huadhënies nga personi tjetër i lidhur, z. ****.****, vlerën totale të ndërtimit prej 2,983,619 lekësh (sipas deklaramentit të subjektit dhe mbështetur në dokumentacionin ligjor të vënë në dispozicion), si shpenzim i vitit 2011, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, nuk ka pasur mundësi për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pasurinën e krijuar në vitin 2011 për një shumë prej 1.4 milionë lekësh, në vijim tabela nr. 3.

³² Shkresa nr.*** prot., datë ****.6.2018.

Tabela nr. 3

Deklarata e interesave vetjakë/periodikë vjetorë 2011	Të ligjshme (lekë)
Gjendja në llogaritë bankare në fillim të vitit	142.059,02
Gjendje <i>cash</i> e akumuluar (sipas deklaratave vjetore)	1.000.000 ³³
Të ardhura nga pagat (total familje)	1.442,440
Shpenzime për ndërtim	2.983,619
Shpenzime minimale konsumi	642.857,14
Shpenzime udhëtimi	238.959,01
Shpenzime mobilim	35.000 ³⁴
Gjendja në llogarite bankare në fund të vitit	87.763,82
Diferenca në mbulimin e shpenzimeve	(1.403.700,04)

46. Në përfundim të arsyetimit ligjor dhe analizës financiare, Komisioneri Publik vlerëson se në rastin e pasurisë “II. Truall + ndërtesë tri kate më sipërfaqe 32 m² (32m²+32m²+48m²), në qytetin e ***”, subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në zbatim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

46.1 Të dyja burimet e deklaruara për krijimin e të ardhurave në vlerën prej 2.983,619 lekësh, që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë së sendit të paluajtshëm: i) kursimet e viteve 2007-2010 dhe ii) huaja nga personi tjetër i lidhur, z. ***.***, nuk rezultojnë të jenë provuar se janë burime të ligjshme në masën e kërkuar, sikundër sanksionon pika 1, 3 dhe 5 e nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

A.a. Deklarime kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit mbi justifikimin e likuiditeteve ndër vite

47. Mbi kursimet ndër vite të deklaruara në deklaratat vjetore, në pyetësorin nr.***, i pyetur nga Komisioni nëse me këto shuma i referohet kursimit gjendje në banesë apo atij në llogaritë bankare, subjekti deklaron se ka qenë i pasaktë mbi plotësimin e likuiditeteve dhe në seksionin përkatës në deklaratat vjetore ka deklaruar shtesën në CASH, duke pasur parasysh dhe shtesat e likuiditeteve në llogaritë bankare, duke justifikuar kështu dhe mosdeklarimin e balancave të llogarive bankare për periudhën deri në 2016, të konstatuara nga Komisioni.

48. Nisur nga ky fakt, Komisioni, pasi referon shkresën nr.*** prot., datë ***.4.2018, të ILDKPKI-së, sqaron se ligji nr. 9049/2003, botuar në Fletoren Zyrtare të majit 2003, përcakton shprehimisht detyrimin e subjekteve të deklarojnë: “...d) vlerën e likuiditeteve, gjendje *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie...”, pra të gjitha në një zë, pa përcaktuar detyrimin për t’i ndarë në zëra.

49. Komisioneri Publik vlerëson se kuptimi i Komisionit nuk është i drejtë, pasi nga mënyra e formulimit të dispozitës dhe teknikës legjislative, kuptohet që likuiditetet mund të jenë në disa forma CASH, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, pra janë në

³³ Kursime vitet 2007 - 2010.

³⁴ Subjekti deklaron se për periudhën 2006 - 2016 ka shpenzuar 350.000 lekë për mobilim/arredim. Duke mos deklaruar periudhën e saktë, shpenzimi i është përlllogaritur në mënyrë lineare për 2006 - 2016.

disa forma dhe duhen deklaruar në mënyrë korrekte sipas formës dhe vendit ku ato (likuiditetet) gjenden. Vetëm në këtë mënyrë duke i paraqitur në zëra të veçantë, garantoheft efektiviteti i kontrollit të tyre, pasi, nëse nuk identifkohet se ku është likuiditeti, nuk mund të realizohet kontrolli efektiv.

50. Nga verifikimi i deklaratave vjetore dhe balancave të llogarive bankare të vëna në dispozicion nga institucionet financiare, nuk konfirmohet sa më sipër deklaroi subjekti. Në deklaratën vjetore të vitit 2012, subjekti ka deklaruar shtesë në kursime shumë 200.000 lekë, burimi: kursime nga puna e kryer, çka në logjikë të sa më sipër deklarimi nga subjekti duhej të përfshinte gjithë ndryshimin e likuiditeteve (si CASH, ashtu dhe në llogaritë bankare). Ndërkohë, nga llogaria e bashkëshortes së subjektit, pranë ***, konstatohet se në këtë vit llogaria rrjedhëse e pagës së saj është shtuar me vlerën 357.196 lekë, si rezultat i kalimit të pagave gjatë vitit 2012³⁵. Për sa më sipër, deklaratimet e subjektit nuk rezultojnë në përputhje me dokumentet e vëna në dispozicion dhe nuk rezultojnë të jetë analizuar si e tillë nga Komisioni kjo rrethanë.

51. Në vitin 2016, vit në të cilin subjekti deklaroi të ketë shlyer huan prej 1.000.000 lekësh ndaj shtetasit ***,*** dhe shumë 7.500 euro ndaj shtetasit ***,***., Komisioni ka konstatuar pamundësinë financiare të subjektit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shlyerjen e huave dhe ka kaluar barrën e provës te subjekti.

51.1 Subjekti ka deklaruar se shuma e likuiditetit e llogaritur në fillim të periudhës nga Komisioni nuk është e saktë, pasi likuiditetet (kursimet CASH) të deklaruara nga subjekti në deklaratën 2015 duhej të llogariteshin në vlerën 700,000 lekë (f. 27 e vendimit) dhe jo 400.000 lekë. Komisioni ka rilogaritur aftësinë financiare të subjektit mbi bazë të deklaratimeve të tij dhe ka konkluduar në një diferencë jositifikative, duke konfirmuar mundësinë e subjektit për shlyerjen e huave dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera me të ardhura të ligjshme.

51.2 Nga verifikimi i deklaratave vjetore 2014 dhe 2015 konstatohet se subjekti deklaroi kursime konkretisht në deklaratën vjetore 2014: *gjendje në CASH jashtë sistemit bankar 300,000 lekë*; deklaratën vjetore 2015: *gjendje në CASH jashtë sistemit bankar 400,000 lekë*, pra subjekti në të dyja rastet në deklaratat vjetore duket se i referohet gjendjes në momentin e deklaratimit dhe bazuar në deklaratimet vjetore të subjektit, nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve deri në vitin 2016, konstatohet se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shlyerjet e deklaruara të detyrimeve dhe shpenzimet vjetore për vitin 2016 (referohu më poshtë).

Tabela nr. 4

<i>Viti</i>		2012	2016
Total të ardhura		1,405,881	2,905,456
Likuiditete në fillim të periudhës		87,763.82	480,380.30
	Konsumi	642,857.14	642,857.14
	Udhëtimi	348,975	405,690
	Investime	0	0
	Shkollimi	0	652,755.21
	Të tjera	35,000	35,000
Shpenzime	Shlyerje huaje	0	2,014,225
Totali i shpenzimeve vjetore		1,026,832.14	3,750,527.35
Likuiditete në fund të periudhës		634,110	139,043

³⁵ Referohu tabelës nr. 4.

51.3 Në konkluzion të sa më sipër analizuar, deklaratimet e subjektit rezultojnë se kanë qenë në mënyrë të përsëritur kontradiktore. Subjekti, pasaktësisht në deklaratimet vjetore të interesave privatë, mund t'i kishte deklaruar dhe saktësuar në deklaratat e tij gjatë periudhave të mëparshme, dhe jo gjatë procesit të rivlerësimit, sa herë që nga Komisioni konstatohej mosmbulim më të ardhura të ligjshme të kursimeve dhe shpenzimeve të deklaruara.

51.4 Për sa më sipër konkludojmë se deklaratimet kontradiktore të subjektit kanë pasur qëllim justifikimin e shpenzimeve dhe kursimeve të deklaruara, dhe subjekti ka kryer deklaratim të pamjaftueshëm edhe për sa i takon likuiditeteve të tij.

IV. Kërkimi i ankimit

52. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit C/2, Ç, D dhe F/7 të aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë, se ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriterin e pasurisë, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së tij, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

53. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara në fashikullin përkatës për çdo subjekt;

54. Referuar nenit D dhe F, të aneksit të Kushtetutës, neneve 30-34 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

55. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 61 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 47, datë 25.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

- Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, magjistrat/gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA